



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18984 Prot.

Lezhë, më 26 . 12 . 2023

VENDIM

Nr. 83, Datë 27. 12. 2023

“PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PËRBASHKËT NDËRMJET BASHKISË SË
VERONËS DHE BASHKISË LEZHË PËR PROJEKTIN “RIGJENERIMI I HAPËSIRËS
PUBLIKE PËRMES KRIJIMIT TË QENDRAVE TË INTEGRUARA TË SPORTEVE PËR
PJESËMARRJEN E TË RINJVE” (RE-GEN), NË KUADËR TË PROGRAMIT URBACT IV”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe konventën e përbashkët ndërmjet Bashkisë së Veronës (partneri kryesor) dhe Bashkisë Lezhë (partner i projektit) për projektin “Rigjenerimi i hapësirës publike përmes qendrave të integruara të sporteve urbane për pjesëmarrjen e qytetarëve të rinj” (RE-GEN) në kuadër të programit URBACT IV, të protokolluar në Bashkinë Lezhë me Nr.16290 Prot., datë 25.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Përbashkët ndërmjet Bashkisë së Veronës dhe Bashkisë Lezhë për projektin “Rigjenerimi i hapësirës publike përmes krijimit të qendrave të integruara të sporteve për pjesëmarrjen e të rinjve” (RE-GEN), në kuadër të programit URBACT IV.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
AGOSTIN MARKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1047/10 Prot.

Lezhë, më 03.01.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.83, datë 27.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Bashkisë së Veronës dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Rigjenerim i hapësirës publike përmes krijimit të qendrave të integruara të sporteve për pjesëmarrjen e të rinjve (RE-GEN) , në kuadër të programit URBACT IV".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

